

Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vendin vakant për Specialist IT & E-LEARNING në Drejtorinë e Kurrikulave pranë Rektoratit, si më poshtë:

Kritere të veçanta që duhet të plotësojë kandidati për Specialist IT & E-LEARNING.

- a) Të zotërojë diplomë të Universitare Master Profesional ose Master Shkencor në Shkencat e Teknologjisë së Informacionit.
- b) Të ketë të paktën 1 vit eksperiencë pune në fushën teknologjisë së informacionit.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Specialist IT E-LEARNING.

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- b) Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- c) Të mos jetë denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- 1. Letrën e motivimit;
- 2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
- 3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- 4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
- 5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
- 6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
- 7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
- 8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
- 10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **29.07.2026** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.